



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

MACEDONIA

ARSIMI PËR NJË EKONOMI MODERNE

JANAR 2006



Nxënësit e prezantojnë atë që e ofrojnë kompanitë e tyre në Panairin e parë të Firmave Virtuale

ARSIMI NË MAQEDONI

- 235.000 nxënës të shkollave fillore.
- Shkalla e regjistrimit 96%.
- 95.000 nxënës të shkollave të mesme.
- Shkalla e kalimit nga shkolla fillore 83%.
- 45.000 studentë universitarë.
- Shkalla e diplomimit me kohë 20%.
- **Arsimi** përbën 3.6% të PKB-së dhe 14% të buxhetit shtetëror.

Për më tepër informata, vizitoni <http://macedonia.usaid.gov>

PROGRAMET

PROJEKTI E-SHKOLLAT

Përmes projektit E-shkollat, USAID-i ka instaluar laboratorit të reja kompjuterike në secilën prej 100 shkollave të mesme në Maqedoni, duke i shfrytëzuar 2.000 kompjuterët e dhuruar nga Republika Popullore e Kinës. Në vitin 2005, E-shkollat do ta kenë përfunduar instalimin e 3.300 kompjuterëve të tjerë në laboratorit të reja pa tel në të gjitha shkollat fillore anembanë vendit. Pas instalimit të kompjuterëve, E-shkollat përqendrohen në ndihmesën për shkollat me qëllim që ato të mësojnë t'i mirëmbajnë laboratorët kompjuterike, në trajnimin e arsimtarëve shkollorë se si ta përdorin teknologjinë e re dhe si fusin në programin mësimor, si dhe krijimin e portalit on-line të resurseve për arsimtarët.

TRAJNIMI THEMELOR PËR AFTËSI NË TEKNOLOGJINË INFORMATIVE

Megjithëse USAID është duke instaluar laboratore kompjuterike nëpër shkollat fillore dhe të mesme, shumë arsimtarëve ende ju mungojnë aftësitë themelore të teknologjisë informative TI, të nevojshme për të ju ndihmuar studentëve që të përfitojnë nga këto resurse të reja. Kjo është sidomos e vërtetë në shkollat fillore anembanë Maqedonisë ku "informatika" nuk ligjërohet deri në klasën e shtatë. Për të mbështetur përdorimin e laboratorëve të ri kompjuterik në shkollat fillore dhe për t'ju ndihmuar arsimtarëve që të fusin në përdorim TI-në në orët e tyre sa më shpejtë që të jetë e mundur, USAID siguroi trajnime themelore për aftësi në TI për 6 000 arsimtarë të shkollave fillore dhe të mesme para vitit shkollor 2005-2006.

MAQEDONIA LIDHET

Zhvillimi i Maqedonisë gjithashtu kërkon një qasje të përmirësuar deri te Interneti, posaçërisht me brez të gjerë frekuencash, me çmim që është i volitshëm për bizneset, shkollat dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Megjithatë, me më pak se 8% qasje deri te Interneti, Maqedonia ngec prapa vendeve të tjera në Evropën Lindore. Përmes projektit Maqedonia lidhet, USAID-i e mbështet përhapjen e internetit me qasje të lehtë dhe me brez të gjerë frekuencash në mbarë vendin. Që nga shtatori i v. 2005, rreth 550 shkolla fillore dhe të mesme, departamente universitare dhe organizata përkrahëse të arsimit në mbarë Maqedoninë kanë qasje të re deri te interneti i shpejtësisë së madhe falë USAID-it. Si rezultat i këtij projekti Maqedonia po njihet poashtu edhe si vendi i parë "pa tel" në botë.

AKTIVITETET NË ARSIMIN E MESËM (SEA)

SEA përqendrohet në përmirësimin e cilësisë së arsimit në 50 shkolla profesionale në Maqedoni dhe përgatitjen e më shumë se 15.000 nxënësve për punësim. Theksi vihet në ndihmën për nxënësit me qëllim që ata të mësojnë më shumë mbi vendet e punës dhe ta zbatojnë njohurinë teorike gjatë kryerjes së detyrave praktike. Nxënësit e lidhin teorinë me praktikën dhe fitojnë njohuri praktike për drejtimin e një kompanie përmes themelimit të bizneseve të nxënësve në 44 shkolla teknike dhe përmes krijimit të firmave të simuluar në shtatë shkolla ekonomike. Bizneset e nxënësve gjithashtu krijojnë edhe të ardhura për shkollat profesionale. Qendrat e karrierës që gjenden në 50 shkolla u ndihmojnë nxënësve që t'i mësojnë shkathtësitë e bërjes së intervistave dhe të shkruarjes së biografisë, qasjes deri te informacioni që ka të bëjë me mundësitë për punësim, si edhe të vendosjes së lidhjeve me bizneset e mirëfillta përmes intervistave dhe stazhimit. Së fundi, SEA i mbështet përmirësimet e administratës shkollore përmes zbatimit të Programit për Çertifikimin e Drejtorëve të Shkollave për 500 drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme, qofshin drejtorë të tashëm ose drejtorë potencialë të shkollave.

PROJEKTI PËR ARSIMIMIN E ROMËVE

Formatted: Swedish (Sweden)



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

MACEDONIA

ARSIMI PËR NJË EKONOMI MODERNE



Fëmijët në një qendër të komunitetit për romët

USAID-i, Fondacioni Instituti i Shoqërisë së Hapur-Maqedoni, fondacioni zviceran Pestaloci, si edhe Organizata për Stabilitet dhe Bashkëpunim në Evropë bashkërisht e financojnë një projekt që ka për qëllim t'i përgatisë nxënësit e moshës parashkollore të regjistruhen nëpër shkolla dhe pastaj të rritet shkalla e të rinjve me përkatësi romë të cilët kalojnë nga shkolla fillore në atë të mesme dhe së fundi në universitete. Në vitin 2004, 269 nxënës të shkollave të mesme dhe 31 studentë universitarë kanë marrë bursë që do t'u ndihmojë ta vazhdojnë shkollimin dhe të jenë të suksesshëm. Përmes këtij projekti, Qendrat edukative romë në Shkup, Kumanovë dhe Prilep në mënyrë aktive japin mbështetje jashtëshkollore dhe aktivitete të tjera kreative për nxënësit, prindërit e tyre, si edhe për mbarë komunitetin. Arsimimi i romëve e mbështet "Dekadën e Përfshirjes së Romëve", një projekt që e zbatojnë tetë shtete të Evropës Juglindore që ka për qëllim ta zvogëlojë hendekun që ekziston në ndihmën sociale dhe kushtet e jetesës ndërmjet romëve dhe atyre që nuk janë romë.

PROJEKTI PËR LIGJËRIM DHE MËSIM KREATIV

Që nga v. 2002, projekti i USAID-it për Ligjërim dhe Mësim Kreativ (LMK) ka futur në përdorim metoda ligjëruese "për të menduarit kritik", ka vendosur 63 laboratorë medial me kompjuterë të rinj dhe lidhje të Internetit, ka futur në përdorim teori të reja për përmirësimin e shkollës dhe aktivitete jashtëshkollore siç janë debatet dhe qeverisja e nxënësve, dhe ka ndihmuar një rrjet të arsimitarëve të interesuar për ligjërimin dhe mësimin kreativ në 18 shkolla të mesme të drejtimit të përgjithshëm dhe 45 shkolla fillore në mbarë Maqedoninë. Që nga v. 2005, projekti LMK është zgjeruar që të përfshijë edhe fakultetet pedagogjike me qëllim që të sigurojë se arsimitarët e ardhshëm e fillojnë punën të pajisur me metodat që përqendrohen në nxënësit dhe me shkathtësi të zhvilluara të TI-së.

HELP - UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

Institucioni i parë privat për arsim sipëror në Maqedoni, Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL), u themelua në nëntor të v. 2001 në Tetovë, për t'u mundësuar shqiptarëve qasje deri te arsimi universitar në gjuhën shqipe. USAID-i, duke qenë donatori më i madh i UEJL-it, i ndihmoi UEJL-it të bëhet një universitet i cilësisë së lartë, multietnik ku mbi 5.000 studentë po arsimohen në gjuhën shqipe, maqedonishte dhe anglishte. Kapacitetet moderne hapësinore të UEJL-it janë të ngjashme me ato të vendeve perëndimore, qendra e tij kompjuterike, që është tërësisht e pajisur, përdor teknologjinë më moderne, ndërsa biblioteka e tij është e pajisur me 15.000 botime dhe libra që janë botuar kohë më parë. Në partneritet me Universitetin e Indianës, me anë të projektit HELP, USAID-i tani përqendrohet në zmadhimin e kapacitetit mësimdhënës në fakultetin e administratës afariste si edhe atë të shkencave dhe teknologjisë së komunikimit.

INFORMACIONE PËR KONTAKT

Drejtor i zyrës për arsim
Leigh Shamblin
Tel: (011-389-2) 308-0446

Postë nga SHBA:
Department of State - USAID
7120 Skopje Place
Wash. DC 20521-7120

Ed Dickens
Macedonia Desk Officer
Tel: (202) 712-1633